

THIRRJE PËR APLIKIM:

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS KËRKON TË REKRUTOJË KOORDINATORE DEPARTAMENTI

APLIKO TANI!

I. PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT

- Verifikon prezencën e pedagogëve në orët e mësimit dhe informon çdo ditë Drejtuesin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Përgjegjës të Departamentit dhe zv.Rektorin për orët e mësimit, të pazhvilluara; në fund të javës përgatit një memo përmbledhëse me shkrim.
- Përgatit relacionin mujor me listë prezencën dhe numrin e orëve të mësimit të zhvilluara nga pedagogët e jashtëm dhe të brendshëm të departamentit i cili pasi firmoset nga Koordinatorja dhe Përgjegjësi i Departamentit, i dërgohet Drejtuesit të Zyrës së Burimeve Njerëzore.
- Mban kontakte të rregullta me studentët që ndjekin programe studimi të Departamentit.
- Në bashkëpunim me përgjegjës të departamentit, përgatit dhe dorëzon tek Sekretari i Përgjithshëm matricën me të dhënat për hartimin e orarit mësimor.
- Trajton kërkesat e studentëve për regjistrim dhe çregjistrim të lëndëve.
- Mbledh detyrat e kursit të studentëve që ndjekin programe studimi të Departamentit përkatës.
- Çdo detyrë tjetër që mund t'i ngarkohet nga Përgjegjësi i Departamentit/Dekani dhe Sekretari i Përgjithshëm.

II. KRITERET PËR PUNËSIM

- Të ketë përfunduar studimet master
- Eksperiencë të mëparshme të ngjashme, 3- 5 vite
- Aftësi shumë të mira komunikuese dhe dëshirë për të punuar në grup
- Aftësi të mira organizative dhe ndërpersonale
- Fleksibilitet në orarin e punës
- Njohuri shumë të mira të kompjuterit (prioritet Excel)

**DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM DUHET TË DORËZOHET ELEKTRONIKISHT, BRENTA DATËS 28 JANAR
2019 NË ADRESËN: hr@uet.edu.al**

- Letër interesi/motivimi
- Curriculum Vitae në gjuhën shqipe (formati europass)
- Letër reference
- Diplomë e arsimit të lartë të kryer (fotokopje)
- Dëshmi të njohurive të kompjuterit

Kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen nëpërmjet e-mailit, për një intervistë vlerësimi.

DIPLOMË PROFESIONALE / BACHELOR / MASTER PROFESIONAL / MASTERI SHKENCAVE / MASTER EKZEKUTIV / PROGRAMETË INTEGRUARA / DOKTORATURË

kontabilitet menaxhim turizëm financë menaxhim biznesi drejtësi marrëdhënie ndërkombëtare shkenca politike sociologji dizajn i aplikuar dhe modë psikologji komunikim arte pamore filozofi histori letërsi linguistikë arte skenike arte muzikore arsim parashkollor edukim fizik dhe sporte aplikime informatike mekatronikë teknologji informacioni inxhinieri informatike inxhinieri industriale inxhinieri ndërtimi infermieri fizioterapi imazheri

FAKULTETI
I EKONOMISË BIZNESIT
DHE ZHVILLIMIT

FAKULTETI SHKENCAVE
JURIDIKE, POLITIKE
DHE MARRËDHËNIEVE
NDËRKOMBËTARE

FAKULTETI
I SHKENCAVE HUMANE
EDUKIMIT DHE
ARTEVE LIBERALE

FAKULTETI
I INXHINIERISË,
INFORMATIKËS
DHE ARKITEKTURËS

FAKULTETI
I SHKENCAVE
MJEKËSORE TEKNIKE